

INFORMACION PËR GJENDJEN ME RASTET ME PERTUSIS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2024/2025, DERI MË 03.04.2025

TË DHËNA JAVORE

Në periudhën 28.03-03.04.2025 është regjistruar një rast i ri me pertusis, nga Kumanova, në moshë nga 10-14 vjet dhe i pavaksinuar me vaksinë e cila përmban komponentë për pertusis. Rasti nuk është hospitalizuar.

Të dhëna kumulative

- Në vitin 2024/25 deri më 03.04.2025 janë regjistruar gjithsej 1.186 raste me pertusis me incidencë 64,6/100.000 banorë.
- Numri më i madh i të sëmurëve jetojnë në Shkup (70,23%) ndërkohë që raste janë regjistruar edhe në 22 qytete të tjera.
- Në RMV ka epidemi aktive në Shkup.
- Numri më i madh i të sëmurëve i përkasin grupmoshës 0-4 vjet (36,9%), ndërsa incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet (1.578,5/100.000).
- Nga numri i përgjithshëm i rasteve (1.186), 750 ose 63,2% nuk kanë qenë të vaksinuar, nuk i kanë marrë të gjitha dozat e vaksinës, ose nuk ka të dhëna për vaksinim.
- Nga rastet që janë plotësisht të vaksinuar, nga pranimi i dozës së fundit ka kaluar mesatarisht 13,7 vjet.
- Në spital janë shtruar 193 persona, ndërsa numri më i madh i tyre (n=170, 88,1%) janë nga 0- 4 vjet, e që kanë qëndruar në spital mesatarisht nga 8 ditë.
- 1.183 raste janë konfirmuar në laborator.
- Nga 18.01.2024 - 23.01.2025 janë dhënë gjithsej 96.114 doza të vaksinës e cila përmban komponentë kundër pertusis.

Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive
ISHPRMV

04.04.2025